Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 të Ligjit për vetëqeverisje lokale (“Gazeta Zyrtare e R.M” nr.5/02), Kryetari i Komunës së Gostivarit, solli:

Врз основа на член 50 став 1 точка 3 од Законот за локална самоуправа (“Службен Весник на Р.М” бр.5/02), Градоначалникот на Општина Гостивар донесе:

A K T V E N D I M

për shpallje të **PROGRAMIT** për aktivitetet e komunës së Gostivarit në lëmin e mundësive të barabarta të grave dhe burrave për vitin **2025**.

Р Е Ш Е Н И Е

за прогласување на **ПРОГРАМА** за активностите на општина Гостивар во областа на еднаквите можности на жените и мажите за **2025** година.

Shpallet **PROGRAMI** për aktivitetet e komunës së Gostivarit në lëmin e mundësive të barabarta të grave dhe burrave për vitin **2025**. nr.08-2495/1 që Këshilli i Komunës së Gostivarit e solli në seancën e mbajtur më datë 30.12.2024.

Се прогласува **ПРОГРАМА** за активностите на општина Гостивар во областа на еднаквите можности на жените и мажите за **2025** година. бр.08-2495/1 што Советот на Општина Гостивар ја донесе на седницата одржана на 30.12.2024 год.

u.d Kryetari i Komunës
в.д Градоначалник
Valbon Limani



“Buletini zyrtar i Komunës së Gostivarit” **“Службен гласник на Општина Гостивар**
Numri 13 30.12.2024 Faqja [70] Страна 30.12.2024 Број 13

Këshilli i Komunës së Gostivarit
Совет на Општина Гостивар
Nr.Бр. 08-2495/1
30.12.2024
Gostivar/Гостивар

Në bazë të nenit 22 par. 1 pika 8 dhe nenit 62 paragrafi 1 të Ligjit për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e RM” numër 05/02), Këshilli i Komunës së Gostivarit në seancën e 41-të solli:

Врз основа на член 22 став 1 точ.8 и член 62 став 1 од Законот за локалната самоуправа (“Службен весник на РМ“ број 05/02), Советот на Општина Гостивар на 41 седница, донесе:

Programi
për aktivitetet e komunës së Gostivarit
në lëmin e mundësive të barabarta
të grave dhe burrave për vitin 2025

Програма
за активностите на општина Гостивар
во областа на еднаквите можности на
жените и мажите за 2025 година

Hyrje

Вовед

Politika e barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave, paraqet një nga parimet fundamentale të demokracisë dhe të rendit shoqëror. Barazia gjinore në Republikën e Maqedonisë, është kategori kushtetuese.

Vendosja e mundësive të barabarta është një shqetësim i të gjithë shoqërisë, të gjitha palët e interesuara në sektorin publik dhe privat dhe paraqet heqje të barrierave dhe krijimin e kushteve për arritjen e barazisë së plotë mes grave dhe burrave. Ky Program për mundësi të barabarta të Komunës së Gostivarit për vitin 2025 është përpiluar në bazë të Ligjit për mundësi të barabarta të grave dhe burrave nga ana e anëtarëve të Komisionit për mundësi të barabarta dhe Kordinatorit për mundësi të barabarta. Pushteti lokal mundet që me anë të kompetencave të veta dhe përmes koordinimit me faktorët e shumtë lokalë, të ndër marrin aksione konkrete në favor të barazisë gjinore,

Политиката на родова рамноправност и зајакнувањето на жените, претставува едно од фундаменталните начела на демократијата и општествениот поредок. Родовата рамноправност во Република Македонија, е уставна категорија.

Воспоставувањето на еднакви можности е грижа на целото општество, на сите субјекти во јавниот и приватниот сектор претставува отстранување на пречките и создавање услови за остварување на потполна еднаквост меѓу жените и мажите. Оваа Програма за еднакви можности на Општина Гостивар за 2025 година е изработена врз основа на Законот за еднакви можности на жените и мажите. Локалната власт може преку своите надлежности и преку координација со многубројните локални фактори, да превзема конкретни акции во корист на половата еднаквост, намалување на



“Buletini zyrtar i Komunës së Gostivarit” **“Службен гласник на Општина Гостивар”**
Numri 13 30.12.2024 Faqja [71] Страна 30.12.2024 Број 13

reduktim të pabarazive dhe promovimin e shoqërisë së mirëfilltë të barabartë.

Edhe krahas rasteve të shumta të njohjes formale dhe progresin e bërë, barazia ndërmejt gjinive ende nuk është një realitet në jetën e përditshme. Në praktikë, burrat dhe gratë nuk gëzojnë të njëjtat të drejta. Ekzistojnë ende pabarazi sociale, politike, ekonomike dhe kulturore. Këto pabarazi janë rezultat i mentalitetit social të imponuar shkakut i stereotipeve të shumta të pranishme në kuadrë të familjeve, arsimit, kulturës, mediave, mjedisin e punës, organizimin e shoqërisë et. Ka kaq shumë fusha në të cilat mund të ndërhyhet me imponimin e një qasjeje të re dhe duke bërë ndryshime strukturore. Fushat kryesore të identifikuar në komunitetin lokal në të cilat duhet të orientohen aktivitetet dhe të intensifikohet puna në vitin 2025 për aprovimin e barazisë gjinore, janë:

- Të drejtat e njeriut - jo-diskriminimi;
- Gruaja dhe proceset vendimmarrëse në komunitetin lokal;
- Ngritja e vetëdijes për kujdesin e gruas mbi shëndetit e vet;
- Përgatitja e statistikave themelore mbi pozitën ekonomike-sociale të grave në komunën e Gostivarit;
- Buxhetim i përgjegjshëm gjinor;
- Forcimi i kapaciteteve / arsim i KMB, këshilltarëve të Këshillit të Komunës, administratës komunale, institucioneve arsimore (si dhe aktorëve të tjerë në jetën shoqërore);
- Intensifikimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit me OJQ-të në fushën e të drejtave të njeriut dhe mundësive të barabarta; dhe
- Ngritja e vetëdijes për kujdesin e shëndetit të një gruaje.

нееднаквостите и промовирањето на вистинско еднакво општество. И покрај бројните примери на јавна препознатливост и постигнат напредок, еднаквоста помеѓу половите сè уште не е реалност во секојдневниот живот. Во пракса мажите и жените не ги уживаат истите права. Сè уште постојат социјални, политички, економски и културни нееднаквости. Ваквите нееднаквости се резултат на социјалниот менталитет наметнат поради бројни стереотипи присутни во рамките на семејството, образованието, културата, медиумите, работната средина, организацијата на општеството итн. Има толку многу области во кои може да се делува со наметнување на нов пристап и правење на структурни промени. Клучните идентификувани области во локалната заедница на кои треба да се насочат активностите и интензивира работата во 2025 година за воведување на родова рамноправност се:

- Човекови права – недискриминација;
- Жената и одлучувачките процеси во локалната заедница;
- Подигање на свеста за грижа на жената за сопственото здравје;
- Изготвување на основни статистички податоци за економско-социјална положба на жените на територијата на општина Гостивар;
- Родово одговорно буџетирање;
- Јакнење на капацитетите/ едукација на КЕМ, советниците од советот на општината, општинска администрација, образовни институции (како и други чинители во општествениот живот);
- Интензивирање и проширување на соработката со НВО од областа на човековите права и еднаквите можностите;
- Подигање на свеста за грижа на жената за сопственото здравје.



I. QËLLIMET

Qëllimi kryesor i Programit për aktivitetet e Komunës së Gostivarit, në Komisionin për mundësi të barabarta të grave dhe burrave për vitin 2025 është që i njëjti të angazhohet për krijimin e politikave lokale dhe rritjen e vetëdijes institucionale dhe të qytetarëve për vendosjen e politikave senzitive gjinore për mundësi të barabarta midis grave dhe burrave, në sferën politike, ekonomike, sociale, arsimore, shëndetësore dhe të tjera të jetës shoqërore, me :

1. Rritja e ndërgjegjësimit të mekanizmave të mbrojtjes të drejtave të njeriut të grave, barazisë gjinore dhe diskriminimit;

2. Vendosja e integritimit gjinor gjatë krijimit të politikave lokale, ngritja e vetëdijes së qytetarëve për politikën gjinore sensitivë, përmes të cilave rritet barazia midis grave dhe burrave.

3. Krijimi i kushteve institucionale për promovimin dhe zhvillimin e pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave në proceset e vendimmarrjes, jetën politike dhe jetën publike në komunitetin lokal / aplikim i denjë i Lijgjit për mundësi të barabarta të grave dhe burrave ("Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 06/12.);

4. Forcimi i kapaciteteve të Komisionit për mundësi të barabarta, këshilltarët në Këshillin e Komunës së Gostivarit, administratën komunale, përfaqësuesve të institucioneve arsimore (si dhe aktorë të tjerë në jetën shoqërore të komunës), me qëllim të arritjes të një niveli më të lartë të vetëdijes për nevojën e barazisë ndërmjet burrave dhe grave në komunitetin lokal me theks të veçantë të grave nga vendet e banuara.

I. ЦЕЛИ

Основни цели на Програмата за активностите на Општина Гостивар во областа на Комисијата за еднакви можности на жените и мажите за 2025 година е дека истиот да се ангажира за формирање на локалните политики и подигање на институционалната свест и на граѓаните за ставање на сензитивите политики за еднакви права меѓу жените и мажите во сфера на политиката, економската, социјалната, и др

1. Подобрување на информираноста на жените за човековите права, механизмите за заштита, родовата рамноправност и дискриминација;

2. Воспоставување родова интеграција при креирање на локални политики, подигање на свеста на граѓаните за родово сензитивни политики, преку кои се зголемува еднаквоста меѓу жените и мажите

3. Создавање институционални услови за унапредување и развој на еднакво учество на жените и мажите во процесите на одлучување, политичкиот живот и јавниот живот во локалната заедница / правилна примена на Законот за еднакви можности на жените и мажите („Сл. на Република Македонија бр. 06/12.);

4. Зајакнување на капацитетите на Комисијата за еднакви можности, советниците во Советот на општина Гостивар, општинската администрација, претставниците на образовните институции (како и другите актери во општествениот живот на општината), со цел да се постигне повисоко ниво на свест на потребата од еднаквост меѓу мажите и жените во локалната заедница со посебен акцент на жените од населените земји.



“Buletini zyrtar i Komunës së Gostivarit” “Службен гласник на Општина Гостивар”
Numri 13 30.12.2024 Faqja [73] Страна 30.12.2024 Број 13

5. Integrimi perspektivës gjinore në politikat instrumentet financiare, në programet, strategjitë dhe dokumentet e tjera që i kontroillon dhe miraton këshilli komunal në pajtim me Ligjin për mundësi të barabarta të grave dhe burrave;

6. Vazhdimi dhe intensifikimi i bashkëpunimit të vetëqeverisjes lokale dhe KMB dhe OJQ-ve për lëndë të punës dhe fushë të veprimit i kanë çështjet që lidhen me të drejtat e njeriut, mbrojtjen e grupeve të marginalizuara dhe të rrezikut social, barazinë ndërmjet burrave dhe grave, mbrojtjen nga diskriminimi dhe të ngjashme.

7. Forcimi i vetëdijes së grave për kujdesin e vazhdueshëm dhe mbrojtjen e shëndetit të tyre; Ekziston nevoja për vetëdije më të madhe të gruas në lidhje me shëndetin e saj seksual dhe riprodhues, edukim më i madh për sëmundjet malinje të organet riprodhuese;

8. Krijimi i një data-baze/mbledhja e të dhënave për perfaqësimin gjinor nga të gjitha institucionet e nivelit lokal.

II. Aktivitetet në vitin 2025

Gjatë vitit 2025, Komuna e Gostivarit planifikon integrimin gjinor në të gjitha fushat me relevance shoqërore, përfshirë krijimin e politikave lokale gjinore, edhe atë: arsim, shëndetësi, kulturë, sport, shkencë, ekonomi, mbrojtje sociale, mbrojtjen e ambientit jetesor, ndryshimet klimatike, të realizohen këto aktivitete në domenin e mundësive të barabarta:

5. Интегрирање на родовата перспектива во политиките, финансиските инструменти, програмите, стратегиите и другите документи кои советот на општината ги контролира и одобрува во согласност со Законот за еднакви можности на жените и мажите;

6. Продолжување и интензивирање на соработката на локалната самоуправа и КЕМ и НВОи за свој предмет на работа и област на делување ги имаат прашањата кои се однесуваат на човековите права, заштита на маргинализираните групи и социјален ризик, еднаквост меѓу мажите и жените, заштита од дискриминација и сл.

7. Зајакнување на свеста на жените за континуирана грижа и заштита на сопственото здравје. Постои потреба од информираност на жената за нејзиното сексуално и репродуктивно здравје како и поголема едукација за малигните заболувања на репродуктивни органи.

8. Креирање на база на податоци/збирка на податоци за родова застапеност од сите институции на локално ниво.

II. Активности во 2025 година

Во текот на 2025 година, Општина Гостивар планира родова интеграција во сите области од социјална релевантност, вклучително и креирање локални родови политики, вклучувајќи: образование, здравство, култура, спорт, наука, економија, социјална заштита, заштита на животната средина, климатски промени. да се спроведат овие активности во доменот на еднакви можности:



Tabela me qëllime, detyra dhe indikator/ Табела со цели, задачи и показатели				
Aktivitete Активност	Përshkrimi i aktivitetit Опис на активност	Qëllimi Цел	Koha Përgjegjës Време Одговорен Resurset finansiare Финансиски ресурси	Indikatorët Индикатори
1.Vendosja e një mekanizmi për sigurimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë në programet dhe raportet e shqyrtuara nga këshilli. -Kontrollimi i dokumenteve respektive nga ana e KMB -Integrimi i politikave te pergjegjshme gjinore gjate krijimit te programeve vjetore -Buxhetim i pergjegjshem gjinor ne Komunen e Gostivarit, per te gjitha programet vjetore	Vendosja e dinamikës së mbledhjes së të dhënave dhe mjeteve të mbledhjes së të dhënave	Siguroni azhurim dhe analiza të rregullta të statistikave dhe informacioneve të ndara sipas gjinisë si bazë për monitorimin dhe planifikimin e masave	Në kontinuitet KMB / Shefat e Sektorëve / Kordinator për Mundësi të Barabarta / Program Mentor KMB/	Lista e indikatorëve Të dhëna të mbledhura



“Buletini zyrtar i Komunës së Gostivarit” “Службен гласник на Општина Гостивар
Numri 13 30.12.2024 Faqja [75] Страна 30.12.2024 Број 13

<p>1. Воведување на механизам за обезбедување родово разделени податоци во програмите и извештаите кои се разгледуваат од советот</p> <p>- Проверка на соодветните документи од страна на КЕМ</p> <p>- Интеграција на одговорни родови политики при креирањето на годишните програми</p> <p>- Одговорно родово буџетирање во општина Гостивар, за сите годишни програми</p>	<p>Воспоставување на динамика на собирање на податоците и алатки за собирање на податоците</p>	<p>Да се обезбеди редовно ажурирање и анализа на родово разделената статистика и информации како основа за следење и планирање мерки</p>	<p>Во континуитет</p> <p>КЕМ /</p> <p>Раководители на сектори /</p> <p>Координатор за еднакви можности /</p> <p>Програма за ментори на КЕМ/</p>	<p>Листа на индикаторни Усвоена Податоци собрани</p>
<p>2. Forcimi i vetëdijes së grave për kujdes të vazhdueshëm dhe mbrojtje të shëndetit të vet;</p> <p>Mamografi falas për 100 gra që vuajn dhe kanë simptoma të kancerit të gjirit.(përfshirë të gjitha etnicitetet dhe vendbanimet urbane dhe rrurale)</p>	<p>Mamografit do të realizohen nga muaj Shkurt deri në muajn Prill në termine të caktuara.</p>	<p>Intervenim, parandalim dhe marja e masave konkrete për shërim të kancerit të gjirit.</p>	<p>Koordinator për Mundësi të Barabarta Në kontinuitet</p> <p>Shkurt, Mars, Prill</p> <p>100,000.00 den</p>	<p>Të dhëna nga spitalet për numrin e personave që kanë kërkuar shërbime mjekësore</p>
<p>2. Јакнење на свеста кај жените за континуирана грижа и заштита на сопственото здравје; Бесплатна мамографија за 100 жени кои боледуваат и имаат симптоми на рак на дојка (вклучувајќи ги сите етникуми и урбани и рурални населби)</p>	<p>Мамограмите ќе се прават од февруари до април во одредени периоди термини.</p>	<p>Интервенција, превенција и преземање конкретни мерки за лекување на ракот на дојка.</p>	<p>Координатор за еднакви можности</p> <p>Во континуитет февруари, март, април</p> <p>100.000,00 ден</p>	<p>Податоци од болниците за бројот на луѓе кои побарале медицински услуги</p>



“Buletini zyrtar i Komunës së Gostivarit” “Службен гласник на Општина Гостивар
Numri 13 30.12.2024 Faqja [76] Страна 30.12.2024 Број 13

<p>3.Vendosja e një mekanizmi për monitorimin e rezultateve të barazisë gjinore</p> <p>-Lobim në komunën e Gostivarit për vendosjen e një mekanizmi me fuqi obliguese, me të cilin të gjitha institucionet lokale do të marrin obligim që të japin raport vjetor me të dhena statistikore gjinore.</p>	<p>Përcaktimi i treguesve të performancës dhe dinamika e monitorimit të tyre</p> <p>Prezantimi i perspektivës gjinore në format e dhënies së asistencës/ fondit dhe raportimit të punëtorisë mbi treguesit e përgjegjshëm gjinor</p>	<p>Vendosja e një mekanizmi për monitorimin e rezultateve të barazisë gjinore</p>	<p>Në kontinuitet KMB / Shefat e Sektorëve / Koordinator për Mundësi të Barabarta / Program Mentor KMB/</p>	<p>Lista e indikatorëve performancë</p> <p>Formular (i ndjeshëm gjinor) i miratuar</p> <p>Punëtorija e mbajtur</p> <p>Numri i pjesëmarrësve të seminarit</p>
<p>3.Воведување на механизам за следење на родово еднакви резултати</p> <p>Лобирање во општина Гостивар за воспоставување на обврзувачки механизам, со кој сите локални институции ќе бидат обврзани да обезбедат годишен извештај со статистички родови податоци.</p>	<p>Утврдување на индикатори за успешност и нивна динамика на следење Презентирање на родовата перспектива во форми на обезбедување помош/фонд и известување од работилница за родово одговорни индикатори</p>	<p>Воспоставување механизам за следење на резултатите од родовата еднаквост</p>	<p>Во континуитет KEM / Раководители на сектори / Koordinator за еднакви можности / Менторска програма KEM/</p>	<p>Список на индикатори за успешност</p> <p>Формулар (родово чувствителен) одобрен</p> <p>Работилница ата се одржа</p> <p>Број на учесници на семинарот</p>
<p>4.Projekt për ngritjen e vetëdijes së grave dhe burave</p> <p>Përkrahje financiar për strehimoren per gra dhe vajza që janë viktime të dhunes në familje, në bashkëpunim me OJQ te dhe institucionet lokale</p>			<p>KMB</p> <p>KEM</p> <p>900,000. Den/ден</p>	



“Buletini zyrtar i Komunës së Gostivarit” “Службен гласник на Општина Гостивар”
Numri 13 30.12.2024 Faqja [77] Страна 30.12.2024 Број 13

<p>Prevenimi dhe ndikimi ne uljen e dhunës ne baze gjinore dhe dhunes ne familje, - Aktivitete konkrete gjate kampanjes 16 dite aktivizem 25 nentor- 10 dhjetor 2025.</p>		<p>Ligjeratë edukative për ngritjen e vetëdijes së gruas për të marë vendime konkrete për vete, familjen, rrethin, shoqërinë etj.</p>	<p>60.000. den/ден</p>	
<p>4Проект за подигање на свеста кај жените и мажите</p> <p>Финансиска поддршка за солиште за жени и девојки кои се жртви на семејно насилство, во соработка со невладини организации и локални институции</p> <p>-Превенција и влијание врз намалувањето на родовото насилство и семејното насилство - Конкретни активности за време на 16-дневната кампања, 25 ноември – 10 декември 2025 година.</p>		<p>Едукативно предавање за подигање на свеста на жените да носат конкретни одлуки за себе, семејството, областа, општеството итн..</p>	<p>KMB KEM 900.000. Den/ден 60.000. den/ден</p>	
<p>5.Analiza gjinore e përdoruesve të programeve: sport, mbrojtje sociale, kulturë etj.</p>	<p>Vendosja e analizës gjinore të programeve</p>	<p>Institucionalizimi i një qasjeje të politikave publike të bazuara në dëshmi</p>	<p>Në nivel vjetor, Kordinatori për mundësi të barabarta/ Program Mentorial</p>	<p>Analiza gjinore e programit: Sport, mbrojtje sociale dhe kulturë</p>
<p>5.Родова анализа на корисниците на програмите: спорт, социјална заштита, култура, и др.</p>	<p>Воведување на родова анализа на програмите</p>	<p>Да се институционализира пристапот на јавни политики засновани на докази</p>	<p>На годишно ниво, Кординатор за еднакви можности/ Ментоска програма</p>	<p>Родова анализа на програмата Спорт, социјална заш</p>



“Buletini zyrtar i Komunës së Gostivarit” “Службен гласник на Општина Гостивар”
Numri 13 30.12.2024 Faqja [78] Страна 30.12.2024 Број 13

6. Aktivitetet tjera të parashikuara			100.000 ден	
Други оперативни расходи				
Vlera e përgjithshme e mjeteve/ Вкупната вредност на средства			1.160.000,00 ден/ден	

Për realizimin e qëllimeve të Komunës së Gostivarit do të ndërmerren të gjitha aktivitetet e nevojshme dhe do t'i vë në dispozicion resurset disponueshme teknike dhe njerëzore. Do të bashkëpunojë me të gjithë aktorët (organizatat, institucionet dhe individët) dhe palët e interesuara për promovimin e barazisë gjinore në nivel lokal, duke përfshirë organizatat qytetare dhe do të jetë një nga partnerët kryesorë në realizimin e aktiviteteve. Në kontekst të objektivave, aktivitetet më së shumti të objektivave të përcaktuara kryesisht do të drejtohen për arsimimin dhe trajnimin e popullsisë dhe të gjitha palëve të interesuara në fushën e mundësive të barabarta.

III. FINANCIMI

Mjetet e duhura për realizimin e Programit për aktivitetet e Komunës së Gostivarit në sferen e mundësive të barabarta për vitin 2025 janë përcaktuar në Buxhetin e Komunës së Gostivarit në lartësi prej: **1.160.000,00** den.

Burimet e Mjeteve

Mjetet nga buxheti i komunës së Gostivarit për realizimin e aktiviteteve të sipërpërmendura për vitin 2025 do të sigurohen nga programa H1

Za realizacija na celite na Programata, Општина Гостивар ќе ги преземе сите потребни активности и ќе ги стави на располагање техничките и човечките ресурси. Ќе соработува со сите чинители (организации, институции и поединци) и засегнати страни за унапредување на родовата рамноправност на локално ниво, вклучително граѓанските организации кои и ќе бидат еден од главните партнери во реализацијата на активностите. Во контекст на дефинираните цели активностите најмногу ќе се насочуваат кон едукација и обука на населението и сите чинители во доменот на еднаквите можности.

III. ФИНАНСИРАЊЕ

Потребните средства за реализирање на Programata за активностите на Општина Гостивар од областа на еднаквите можности на жените и мажите за 2025 година се определени во Бюџетот на општина Гостивар во износ од: **1.160.000,00** ден

Извори на средства

Средствата од буџетот на општина Гостивар за реализација на горенаведените активности за 2025 година ќе бидат обезбедени од програмата H1



Programa per mundesi te barabarta për burat dhe grat H1		
Zëri"	Përshkrimi	shuma
463110	Transfere deri te shoqatat"	900,000.00
471990	Ndihmë tjera sociale"	100,000.00
425990	Shërbime tjera kontraktuese"	60,000.00
426990	Shpenzime tjera operative"	100,000.00
Gjithsej		1,160,000.00

III. METODAT E PUNËS

Metodat themelore që do të përdoren në zbatimin e aktiviteteve janë:

- **Takime pune** - Të organizuara për koordinim me KMB, kryetarin e komunës (administratën komunale) dhe partnerë të tjerë në zbatimin e aktiviteteve (ekspertë në fusha të caktuara, OJQ-të dhe grupet qëllimore të qytetarëve, etj) të cilët do të marrin pjesë në zbatimin e aktiviteteve;

- **Metodat diskutuese trajnuese** - do të përdoren në kuadër të trajnimeve, ligjëratave, konsultimeve dhe të ngjashme, në përputhje me aktivitetet. Në formën e trajnimit, mësimdhënies, këshillimit etj. do të shfrytëzohen teknologjitë moderne arsimore, audiovizuale dhe produktet multimedia arsimore.

Pyetësorët evaluativ të plotësuar nga ana e pjesëmarrësve në aktivitetet;

- **Metodat hulumtuese analitike** – shfrytëzohen për studim dhe analizë të arritjes së objektivave. Sipas prioritetit do të aplikohen metodat e analizës, grumbullimit, analizës dhe

"Програма за еднаквите можности на жените и мажите X1"		
"Ставка	Опис	Износ
463110	"Трансфери до здружениа	900,000.00
471990	"Друга социјална помош	100,000.00
425990	"Други договорни услуги	60,000.00
426990	"Други оперативни расходи	100,000.00
Вкупно		1,160,000.00

III. МЕТОДИ НА РАБОТА

Основни методи кои ќе бидат користени во реализација на активностите се:

- **Работни средби** – Организирани за координација помеѓу КЕМ, Градоначалникот (општинската администрација) и другите партнери во реализација на активностите (експерти од одредени области, НВО-и, целни групи на граѓани и др.) кои ќе учествуваат во имплементацијата на активностите;

- **Дискусионо обучувачки методи** – ќе бидат користени во рамките на спроведување на обуките, предавањата, советувањата и сл. согласно активностите. Во формата на обуките, предавањата, советувањата и сл. ќе се користат современи образовни технологии, аудио визуелни и мултимедијални образовни продукти.

Евалуативни прашалници пополнети од страна на учесниците во активностите;

- **Истражувачко аналитички методи**- ќе се користат при проучување и анализа на постигање на целите. Приоритетно ќе се применуваат методите на анализа, собирање,



“Buletini zyrtar i Komunës së Gostivarit”

“Службен гласник на Општина Гостивар

Numri 13 30.12.2024

Faqja

[80]

Страна

30.12.2024

Број 13

sistematizimit të informacionit (intervistat dhe anketat me grupet qëllimore);

- **Informative promovuese** - ky lloj i metodës do të shfrytëzohet për distribuim dhe prezantim të materialeve reklamuese dhe propaganduese, organizimin e trajnimeve, ligjëratave, këshillimin dhe nevojat e tjera në përputhje me përmbajtjen e aktiviteteve;

- **Juridike** - do të shfrytëzohen gjatë zbatimit të procedurave për përzgjedhjen e ofertuesve për realizimin e aktiviteteve në kuadër të Ligjit për prokurime publike në Republikën e Maqedonisë;

- **Metodat e kontabilitetit financiar** - do të shfrytëzohen në procesin e përgatitjes së buxheteve për secilin aktivitet veç e veç, raportet financiare periodike dhe përfundimtare për realizimin e aktiviteteve;

IV. FINANCIMI

Financimi i aktiviteteve do të zbatohet me fonde nga Buxheti i Komunës së Gostivarit.

V. MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Komisioni për mundësi të barabarta për gratë dhe burrat pranë Këshillit të Komunës së Gostivarit dhe koordinatorit për mundësi të barabarta të cilët e përgatitën këtë dokument do ta ndjekin rrjedhën dhe dinamikën e zbatimit të Programit dhe do të japin vlerësime si dhe propozime për ndryshimet e domosdoshme në mënyrë që të arrihet deri te qëllimet e përcaktuara.

Deri te Këshilli i Komunës, Kryetari i Komunës dhe Sektori për mundësi të barabarta pranë Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale nga ana e koordinatorit për mundësi të barabarta të burrave dhe grave do të dorëzojnë raporte vjetore për zbatimin e aktiviteteve dhe realizimin e objektivave. Në pjesën e evaluimit do të kuçet

analiziraње и систематизирање на информацијата (интервјуа и анкети со целните групи);

- **Информативно промотивни** – овој тип на метод ќе се користи при дистрибуцијата и презентирањето на рекламните и пропагандните материјали, организацијата на обуките, предавањата, советувањата и други потреби согласно содржината на активностите;

- **Правни** – ќе се користат при спроведувањето на процедурите за избор на понудувачи за реализација на активностите согласно Законот за јавни набавки во Р. Македонија;

- **Финансиско сметководствени методи** – ќе се користат во процесот на подготовка на буџетите за секоја активност поединечно, периодичните и финалните финансиски извештаи за реализација на активностите;

IV. ФИНАНСИРАЊЕ

Финансирањето на активностите ќе се реализира со средства од Буџетот на Општина Гостивар.

V. МОНИТОРИНГ И ЕВАЛУАЦИЈА

Комисијата за еднакви можности на жените и мажите при Советот на Општина Гостивар и координаторот за еднакви можности кои го изработуваа овој документ ќе го следат текот и динамиката на спроведување на Програмата и ќе даваат свои оценки како и предлози за неопходни промени се со цел постигнување на утврдените цели.

До Советот на Општината, Градоначалникот и Секторот за еднакви можности при Министерството за труд и социјална политика од страна на координаторот за еднакви можности на мажите и жените ќе се доставува годишен извештаи за имплементација на активностите и реализацијата на целите. Во делот на



“Buletini zyrtar i Komunës së Gostivarit”

“Службен гласник на Општина Гостивар

Numri 13 30.12.2024 Faqja

[81]

Страна

30.12.2024

Број 13

edhe Sektori për mundësi të barabarta pranë Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale. Ky vendim hyn në fuqi me Buxhetin e vitit 2025 dhe Vendimin për ekzekutimin e Buxhetit për vitin 2025.

евалвацијата ќе се вклучи и Секторот за еднакви можности при Министерството за труд и социјална политика. Оваа одлука влегува во сила со Буџетот за 2025 година и со одлуката за извршување на Буџетот за 2025 година.

Kryetari i Këshillit të Komunës së Gostivarit
Претседател на Советот на Општина Гостивар
Namik Durmishi



“Buletini zyrtar i Komunës së Gostivarit” **“Службен гласник на Општина Гостивар**
Numri 13 30.12.2024 Faqja [82] Страна 30.12.2024 Број 13

Nr.Бр.09-2531/13
31.12.2024
Gostivar/ Гостивар

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 të Ligjit për vetëqeverisje lokale (“Gazeta Zyrtare e R.M” nr.5/02), Kryetari i Komunës së Gostivarit, solli:

Врз основа на член 50 став 1 точка 3 од Законот за локална самоуправа (“Службен Весник на Р.М” бр.5/02), Градоначалникот на Општина Гостивар донесе:

A K T V E N D I M

për shpallje të **PROGRAMI** për shëndet publik për Dezinfektim ,Dezinsektim dhe Deratizim në Komunën e gostivarit për vitin **2025.**

P E Ш Е Н И Е

за прогласување на **ПРОГРАМА** за јавно здравје, Дезифекција, Дезифекција и Дератизација на Општина Гостивар за **2025** година.

Shpallet **PROGRAMI** për shëndet publik për Dezinfektim ,Dezinsektim dhe Deratizim në Komunën e gostivarit për vitin **2025.** nr.08-2496/1 që Këshilli i Komunës së Gostivarit e solli në seancën e mbajtur më datë 30.12.2024.

Се прогласува **ПРОГРАМА** за јавно здравје, Дезифекција, Дезифекција и Дератизација на Општина Гостивар за **2025** година. бр.08-2496/1 што Советот на Општина Гостивар ја донесе на седницата одржана на 30.12.2024 год.

u.d Kryetari i Komunës
в.д Градоначалник
Valbon Limani



“Buletini zyrtar i Komunës së Gostivarit” **“Службен гласник на Општина Гостивар**
Numri 13 30.12.2024 Faqja [83] Страна 30.12.2024 Број 13

Këshilli i Komunës së Gostivarit
Совет на Општина Гостивар
Nr.Бр.08-2496/1
30.12.2024
Gostivar/Гостивар

Në baz të nenit 22 alinea 1, pika 2 dhe nenit 36 alinea 1, pika 1 nga Ligji për vetqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02)

Këshilli i komunës së Gostivarit në këshillin e mbajtur më 30.12.2024 solli:

Врз основа на член 22 став 1 точка 2 и член 36, став 1, точка 1 од Законот за локалната самоуправа (“Службен весник на РМ“ бр. 5/02)на седница одржана на 30.12.2024 година, донесе:

**PROGRAMË PËR SHËNDET PUBLIK
për Dezinfektim ,Dezinsektim dhe Deratizim
në Komunën e gostivarit për vitin 2025**

**ПРОГРАМА ЗА ЈАВНО ЗДРАВЈЕ
Дезинфекција, Дезинсекција и
Дератизација на Општина Гостивар
за 2025 година**

Нурје

Вовед

Në këtë program është paraparë aktiviteti gjithëpërfshirës, masat dhe detyrat që duhet t'i realizojë Komuna e Gostivarit gjatë vitit 2025. Me këtë u sigurohet të gjithë qytetarëve realizim i të drejtave të garantuara, nevojat e konstatuara dhe interesat nga Ligji për mbrojtje shëndetësore që kanë karakter të avancimit të shëndetit dhe ndërmarrjen e hapave dhe aktiviteteve për parandalimin e sëmundjeve në territorin e komunës.

Во оваа програма е предвидена целокупната активност, мерките и задачите што треба да ги реализира Општина Гостивар во текот на 2025 година. Со неа им се обезбедува на сите граѓани остварување на загарантирани права, утврдени потреби и интереси од Законот за здравствена заштита што имаат карактер на унапредување на здравјето и превземање мерки и активности за спречување на заболувањата на подрачјето на општината.

Me këtë program vërtetohen masat për pengimin e dukurive, zbulimi i hershëm, parandalimi i përhapjes së sëmundjeve ngjitëse dhe infeksioneve, të drejtat dhe obligimet e institucioneve shëndetsore, persona juridik dhe fizik si dhe mbykqirësi mbi të realizuarën për

Со оваа Програма се утврдуваат мерките за спречување на појавата, рано откривање, спречување на ширењето и сузбивање на заразни болести и на инфекции, правата и обврските на здравствените Установи,



masat me qëllim për mbrojtjen e popullatës nga sëmundjet ngjitëse.

Qendrat periferitë për shëndet publik e ndjekin gjendjen epidemiologjike me sëmundjet ngjitëse për të cilat janë themeluar, dhe për gjendjen e informojn Institutin për Shëndet Publik në RMV dhe komunat.

Aktivitetet e Planifikuar

Në pajtim me nenin 39 nga Ligji për sëmundjet ngjitëse janë paraparë aktivitetet e radhës për preventivë dezinfektimin, dezinfektimi dhe deratizimi në teritorin e Komunës së Gostivarit.

Dezinfektimi në teritorin e Komunës së Gostivarit

Me dezinfektimin do të përfshihen të gjitha shkollat në teritorin e komunës së Gostivarit, Konvikti i nxënësve dhe të gjithë objektet administrative në kompetencë të komunës së Gostivarit, dy herë në vit edhe atë në muajin Janar dhe Gusht.

Loji i mjeteve për dezinfektimin në përputhje me Lejen nga Biroja për barna e lejon kryerjen e shërbimit, i cili do të furnizohet me të njejtën.

Pas kryerjes së dezinfektimit realizuesi duhet të dorëzojë raport deri te Komuna e Gostivarit, ndërsa Komuna e Gostivarit deri te Qendra për Shëndet Publik.

правни и физички лица како и надзорот над спроведувањето на мерките со цел на заштита на население од заразни болести.

Центрите за јавно здравје ја следат епидемиолошката состојба со заразните болести на подрачјето за кое се основани, и за состојбата го известуваат Институтот за Јавно Здравје на РСМ и општините.

Планирани Активности

Во согласност со член 39 од Законот за заразни болести предвидени се следните активности за вршење на превентивна дезинфекција, дезинсекција и дератизација на територија на Општина Гостивар.

Дезинфекција на територијата на Општина Гостивар

Со дезинфекција ќе се опфатат сите училишта во територијата на општина Гостивар, интернатот и сите административни објекти во надлежност на општина Гостивар, два пати годишно во месец Јануари и Август.

Типот на средствата за дезинфекција согласно Одобрението од Бирото за лекови го одредува избраниот Извршител, кој ќе ја набави истата.

По извршената дезинфекција извршителот треба да достави извештај до Општина Гостивар, додека Општина Гостивар до Центар за Јавно Здравје.



Dezinsektimi i teritorit të Komunës së Gostivarit

Me dezinfektimin do të përfshihet teritori i komunës së Gostivarit me hapësirë prej 150 ha.

Dezinsektimi duhet të bëhet në tri intervale kohore.

Dezinsektimi bëhet me mjete insekticide me metodën e aerosol me VRU gjenerator për mjegullimin e ftoht.

Dezinsektimi duhet të realizohet në muajin Qershor, Korik dhe Gusht.

Periodi i trajtimit do të realizohet në bazë të kushteve klimaterike, vetëm në kushte të volitëshme kohore jo në kushte me errëra të forta dhe me shi.

Koha e realizimit: Në kohët e vona të natës prej ora 21.30 deri në orën 2.30(të mëngjesit).

Dezinsektimi, të realizohet me preparatet më bashkkohe ekologjike të cilat janë të regjistruara nga ana e Ministrisë së Shëndetësis në RMV.

Lloji i preparatit për dezinfektim në pajtueshmëri Lejen nga Byroja për Barna e përcakton realizuesin e zgjedhur, i cili do ta furnizoj të njëjtën.

Pas realizimit të dezinfektimit realizuesi duhet të dorëzoj raport deri te Komuna e Gostivarit, ndërsa Komuna e Gostivarit deri te Qendra për Shëndet Publik.

Dezinsekcija на територијата на Општина Гостивар

Со дезинсекција ќе се опфати територијата на град Гостивар со површина од 150 ха.

Dezinsekcija треба да се изведе во три временски интервали.

Dezinsekcijata се врши со инсектицидно средство преку метода на aerosol со УЛВ генератор за ладно замаглување.

Dezinsekcija треба да се изврши во месец Јуни, Јули и Август.

Периодот на третирање ќе се изврши спрема временската прилика, само под поволни временски услови не во време со дожд и јак ветер.

Време на изведување: Во вечерни часови од 21.30 часот до 2.30 часот (наутро).

Dezinsekcijata, да биде извршена со најсовремени еколошки препарати кој се регистрирани од страна на Министерство за Здравство на РСМ.

Типот на средствата за дезинсекција согласно Одобрението од Бирото за Лекови го одредува избраниот Извршител, кој ќе ја набави истата.

По извршената дезинсекција извршителот треба да достави извештај до Општина Гостивар, додека Општина Гостивар до Центар за Јавно Здравје.



Дератизација на територијата на Општина Гостивар

Deratizimi në Teritorin e Komunës së Gostivarit

Me deratizimin do të përfshihen rrjeti i kanalizimit përafërshisht deri në 600 puseta, të gjitha shkollat në teritorin e Komunës së Gostivarit, Konvikti të gjith objektet administrative të cilat janë në kompetenc të komunës së Gostivarit dhe kaptazhi (vendgrumbullimi i ujit) në fshatin Vrutok, dy erë në vit në Pranëverë dhe në Vjeshtë.

Periodi i trajtimit do të realizohet në bazë të kushteve klimaterike, vetëm në kushte të volitëshme kohore jo në kushte me shi dhe me errërra të forta.

Koha e realizimit :Në koh të orarit të punës së NP- Komunalec nga ora 8.00 deri në orën 16 .00 prej ditës së Hënë deri të Premten, për arësye se duhet ti hapin dhe mbyllin pusetat.

Deratizimi do të realizohet me vendosjen e kurthet me helme rodenticide kundër minjëve dhe kobaj në vende të caktuara të cilët i përcakton Qendra për Shëndet Publik.

Llojin e mjeteve për deratizim në përputhshmëri me Buroja për Barna e përcakton realizuesin e zgjedhur, i cili do ta furnizoj të njëjtën.

Pas realizimit të deratizimit realizuesi duhet të dorëzoj raport deri te Komuna e Gostivarit, ndërsa Komuna e gostivarit deri te Qendra për Shëndet Publik.

Со дератизација ќе се опфати канализационата мрежа со околу 600 шахти, сите училишта во територијата на општина Гостивар, интернатот, сите административни објекти во надлежност на општина Гостивар и каптажата во село Вруток два пати годишно во Пролет и Есен.

Периодот на третирање ќе се изврши спрема временската прилика, само под поволни временски услови не во време со дожд и јак ветер.

Време на изведување: Во текот на Работното време на ЈКП Комуналец т.е. од 8:00 до 16:00 часот од Понеделник до Петок, затоа што ќе треба да отвараат и затвараат шахти.

Дератизацијата ќе биде извршена со поставување на родентицидни мамци-отрови против глувци и стаорци на соодветни места кои ги одредува Центарот за Јавно Здравје.

Типот на средствата за дератизација согласно Одобрението од Бирото за Лекови го одредува избраниот Извршител, кој ќе ја набави истата.

По извршената дератизација извршителот треба да достави извештај до Општина Гостивар, додека Општина Гостивар до Центар за Јавно Здравје.



“Buletini zyrtar i Komunës së Gostivarit” **“Службен гласник на Општина Гостивар**
Numri 13 30.12.2024 **Faqja** **[87]** **Страна** **30.12.2024** **Број 13**

Извор на средства: буџетот на општината.
600.000,00 ден.

Burimi i mjeteve: buxheti i komunës 600.000,00
den.

Оваа Програма влегува во сила со денот на
објавувањето во “Службен гласник на
Општина Гостивар”.

Кјо програм hynë në fuqi në ditën e shpalljes
në” Buletinin zyrtar i vkomunës së
Gostivaritë”.

Kryetari i Këshillit të Komunës së Gostivarit
Претседател на Советот на Општина Гостивар
Namik Durmishi



“Buletini zyrtar i Komunës së Gostivarit” **“Службен гласник на Општина Гостивар**
Numri 13 30.12.2024 Faqja [88] Страна 30.12.2024 Број 13

Nr.Бр.09-2531/14
31.12.2024
Gostivar/ Гостивар

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 të Ligjit për vetëqeverisje lokale (“Gazeta Zyrtare e R.M” nr.5/02), Kryetari i Komunës së Gostivarit, solli:

Врз основа на член 50 став 1 точка 3 од Законот за локална самоуправа (“Службен Весник на Р.М” бр.5/02), Градоначалникот на Општина Гостивар донесе:

A K T V E N D I M

për shpallje të **PROGRAMIT** për aktivitetet e Komunës së Gostivarit në sferën e mbrojtjes sociale, mbrojtjes shëndetësore dhe mbrojtjes së fëmijëve për vitin **2025**.

Р Е Ш Е Н И Е

за прогласување на **ПРОГРАМА** за активностите на Општина Гостивар во областа на социјалната и детската заштита во **2025** година.

Shpallet **PROGRAMI** për aktivitetet e Komunës së Gostivarit në sferën e mbrojtjes sociale, mbrojtjes shëndetësore dhe mbrojtjes së fëmijëve për vitin **2025**. nr.08-2497/1 që Këshilli i Komunës së Gostivarit e solli në seancën e mbajtur më datë 30.12.2024.

Се прогласува **ПРОГРАМА** за активностите на Општина Гостивар во областа на социјалната и детската заштита во **2025** година. бр.08-2497/1 што Советот на Општина Гостивар ја донесе на седницата одржана на 30.12.2024 год.

u.d Kryetari i Komunës
в.д Градоначалник
Valbon Limani



“Buletini zyrtar i Komunës së Gostivarit” “Службен гласник на Општина Гостивар”
Numri 13 30.12.2024 Faqja [89] Страна 30.12.2024 Број 13

Këshilli i Komunës së Gostivarit
Совет на Општина Гостивар
Nr.Бр. 08-2497/1
30.12.2024
Gostivar/Гостивар

Në bazë të nenit 22, paragrafi 1 pika 5 dhe nenit 36 të Ligjit për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e RM-se” nr 05/02), dhe nenit 142, paragrafi 5 të Ligjit për Mbrojtje Sociale (“Gazeta zyrtare e RM-se” nr 104/2019 dhe 146/2019), Këshilli i Komunës së Gostivarit në seancën 41-të mbajtur më 30.12.2024 solli:

Според член 22, став 1, точка 5 и член 36 од Законот за локалната самоуправа (“Службен весник на РМ” број 05/02), и членот 142, став 5 од Законот за социјалната заштита („Службен весник на РСМ“ бр.104/2019 и 146/2019) Советот на Општина Гостивар на 41 седница, одржана на 30.12.2024 година донесе:

PROGRAM

për aktivitetet e Komunës së Gostivarit në sferën e mbrojtjes sociale, mbrojtjes shëndetësore dhe mbrojtjes së fëmijëve për vitin 2025

ПРОГРАМА

за активностите на Општина Гостивар во областа на социјалната, здравствена и детската заштита во 2025 година

Mbrojtja sociale, mbrojtja e fëmijëve dhe kujdesi shëndetësor në Komunën e Gostivarit bazohet në zbatimin e Ligjit për Mbrojtje Sociale; Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve; Programën për zhvillimin e mbrojtjes së fëmijëve në RMV; Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Statutin e Komunës së Gostivarit me të cilat rregullohen të drejtat në fushën e mbrojtjes sociale, mbrojtjes shëndetësore dhe mbrojtjes së fëmijëve.

Programi ka për qëllim zbatimin e prioriteteve strategjike të Komunës për vitin aktual, në përputhje me Buxhetin e Komunës së Gostivarit, por edhe masave të përcaktuara me ligje dhe programe në nivel kombëtar.

I. QËLLIMI

Qëllimi bazë i këtij Programi është:

Социјалната заштита, заштитата на децата и здравствената заштита во Општина Гостивар се засноваат на примена на Законот за социјалната заштита; Законот за заштита на децата; Програмата за развој на заштитата на децата во РСМ; Законот за локалната самоуправа и Статутот на Општина Гостивар, со кои се уредени правата од областа на социјалната, детската и здравствената заштита.

Целите на Програмата се стратешките и приоритетите на Општина за тековната година согласно Буџетот на Општина Гостивар, но и мерките утврдени со закони и програмите на национално ниво.

I. ЦЕЛИ

Основни цели на оваа Програма се:



“Buletini zyrtar i Komunës së Gostivarit”

Numri 13 30.12.2024 Faqja [90]

“Службен гласник на Општина Гостивар

Страна 30.12.2024 Број 13

-Sigurimi i raportit aktiv nga ana e Këshillit të Komunës së Gostivarit rreth plotësimit të nevojave në sferën e mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve ;
-Bashkëpunim aktiv me institucionet në nivel lokal dhe kombëtar me sektorin joqeveritar dhe privat.
-Sigurimi i jetesës cilësore për personat që kanë nevoja për mbrojtje sociale.
-Integrimin dhe socializimin e grupeve të marginalizuara të qytetarëve në shoqëri.
-Krijimi i kushteve për shërbime cilësore për nevojat e fëmijëve në territorin e Komunës së Gostivarit.
-Mbështetja, integrimi dhe krijimi i kushteve cilësore të fëmijëve me aftësi të kufizuara në procesin arsimor dhe shoqëror.
- Realizimi dhe promovimi i të drejtave të personave me status të rrezikuar social.
- Zhvillimi dhe rritja e shërbimeve sociale në territorin e Komunës së Gostivarit duke respektuar rregullat ligjore dhe parimin e barazisë për mundësi të barabarta për mbrojtje sociale, mbrojtjen e fëmijëve dhe kujdesit shëndetësor.

II. AKTIVITETET

Aktivitetet në Komunën e Gostivarit do të realizohen në katër fusha:

FUSHA 1 MBROJTJE SOCIALE
FUSHA 2 MBROJTJA E FËMIJËVE
FUSHA 3 KUJDESI SHËNDETËSOR
FUSHA 4 REALIZIMI I AKTIVITETEVE DHE MANIFESTIMI I DATAVE TË RËNDËSISHME NGA FUSHA SOCIALE SI DHE REALIZIMI I AKTIVITETEVE TE PA PLANIFIKUARA NGA KËRKESAT E QYTETARËVE DHE SHOQATAVE

FUSHA 1- MBROJTJE SOCIALE

- Обезбедување активен однос на Советот на Општина Гостивар кон исполнување на потребите од областа на социјалната и детска заштита;
-Активна соработка со институциите на локално и национално ниво, со невладиниот и приватниот сектор
-Обезбедување на квалитетен живот за лицата на кои им е потребна социјална заштита.
-Интеграција и социјализација на маргинализираните групи граѓани во општеството.
- Создавање услови за квалитетни услуги за потребите на децата на територијата на општина Гостивар.
- Поддршка, интеграција и создавање на квалитетни услови за децата со попреченост во образовниот и социјалниот процес.
- Остварување и унапредување на правата на лицата со социјално загрозен статус.
- Развојот и растот на социјалните услуги на територијата на Општина Гостивар со почитување на законските правила и принципот на еднаквост за еднакви можности за социјална заштита, детска заштита и здравствена заштита

II. АКТИВНОСТИ

Активностите во Општина Гостивар ќе се реализираат во четири области:

ОБЛАСТ 1 СОЦИЈАЛНА ЗАШТИТА
ОБЛАСТ 2 ДЕТСКА ЗАШТИТА
ОБЛАСТ 3 ЗДРАВСТВЕНА ЗАШТИТА
ОБЛАСТ 4 РЕАЛИЗАЦИЈА НА АКТИВНОСТИ И МАНИФЕСТАЦИЈА НА ВАЖНИ ДАТУМИ ОД СОЦИЈАЛНАТА ОБЛАСТ КАКО И РЕАЛИЗАЦИЈА НА ДРУГИ НЕПЛАНИРАНИ АКТИВНОСТИ ПО БАРАЊА ОД ГРАЃАНИ И ЗДРУЖЕНИЈА

ОБЛАСТ 1- СОЦИЈАЛНА ЗАШТИТА



“Buletini zyrtar i Komunës së Gostivarit”

Numri 13 30.12.2024 Faqja [91]

“Службен гласник на Општина Гостивар

Страна 30.12.2024 Број 13

Në bazë të nenit 4 paragrafi 1 pika 2 të Ligjit për mbrojtje sociale “Rreziku social” është gjendje që e vështirsonë ose pengon funksionimin e qetë të individit në shoqëri, familje dhe grupe të caktuara, i cili mund të ketë nevojë për ndihmë sociale. Rreziqet sociale ndaj të cilave individit është i ekspozuar sipas këtij ligji janë: amësia, sëmundja, pleqëria, vdekja, lëndimi dhe paaftësia.

1.Në programën për aktivitetet e Komunës së Gostivarit në sferën e mbrojtjes sociale dhe mbrojtjes së fëmijëve për vitin 2024 personat me rrezik social në bazë të kërkesave të tyre janë paraparë të ndihmohen në këto fusha të cilat janë të parapara edhe në Ligjin për mbrojtje sociale:

- Njerëzit të cilët janë të rrezikuar në shoqëri, persona të pastrehë;
- Personat që janë përfitues të ndihmës sociale dhe të cilët janë të paaftë për punë ose u është hequr aftësia për punë;
- Personat e moshuar dhe pa përkujdesje familjare;
- Prindërit vetëushqyesë;
- Viktimat e dhunës në familje.

Personat me aftësi të kufizuara

- Personat me aftësi të kufizuara intelektuale, fizike dhe lloje të tjera të aftësive të kufizuara;
- Personat me aftësi të kufizuara intelektuale që frekuentojnë Qendrat Ditore për personat me aftësi të kufizuara;
- Personat e papunë të cilët janë në listën e të papunëve në Qendrën e Punësimit në Komunën e Gostivarit;

FUSHA 2 MBROJTJA E FËMIJËVE

Komuna e Gostivarit në kuadër të realizimit të qëllimeve dhe detyrave të përcaktuara në këtë program bazuar në kompetencat e komunës në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, mjete nga buxheti komunal janë paraparë për këto kategori me rrezik social:

- Fëmijët me probleme sociale arsimore;

Согласно членот 4, став 1, точка 2 од Законот за социјалната заштита, “Социјален ризик” е состојба која има потенцијал да го отежни или оневозможи непреченото социјалното функционирање на поединецот, семејството и одредена група, која може да дојде во состојба да има потреба од социјална помош. Основните социјални ризици на кои е изложен поединецот во смисла на овој закон се: мајчинство, болест, старост, смрт, повреда и попреченост.

1.Во Програмата за социјална, детска и здравствена заштита на Општина Гостивар за 2024 година лицата во социјален ризик како целна група се опфатени со неколку видови помош кои се предвидени и во Законот за социјална заштита:

- Лица кои се социјално загрозувани, бездомни лица;
- Лица кои се приматели на одредена помош кои се неспособни за работа или им е одземена работната способност;
- Стари и изнемоштени лица без семејна грижа;
- Самохрани родители;
- Лица жртви на семејно насилство

Лице со попреченост

- Лица со интелектуална, телесна попреченост и друг вид на попреченост;
- Лица со интелектуална попреченост кои присуствуват во Дневниот центар за лица со интелектуална попреченост;
- Невработени лица кои се на листата на невработени во Центарот за вработување во Општина Гостивар;

ОБЛАСТ 2 ДЕТСКА ЗАШТИТА

Општина Гостивар, во рамките на остварување на основните цели и задачи дефинирани во оваа програма врз основа на надлежностите на општината во областа на детската заштита, средства од општинскиот буџет обезбедени за следните категории на социјален ризик:

- Деца со воспитно социјални проблеми;



- Fëmijët pa prindër dhe kujdes prindëror;
- Fëmijët në rrugë;
- Fëmijët me prindër vetëushqyes;
- Fëmijët me aftësi të kufizuara intelektuale dhe fizike;
- Mbështetje financiare për shkollim për nxënësit që janë raste me rrezik social ose aftësi të kufizuara intelektuale dhe fizike
- Asistencë për mjete shkollore për nxënësit e me rrezik social,
- Kuçja aktive e fëmijëve me rrezik social në institucionet parashkollore gjegjësisht çerdhet e qytetit;
- Kuçja aktive e fëmijëve të komunitetit romë në institucionet parashkollore dhe zvogëlimi i dukurisë lypëse;
- Kuçja e fëmijëve në aktivitete dhe manifestime sportive , kulturës, kreative dhe manifestime tjera;

FUSHA 3 KUJDESI SHËNDETËSOR

